



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 19/2020 (JR)
Nr. 19/2020 regj.

Tiranë më 07.12.2020

SHPALLJE

E

NJOFTIMIT PËR ZHVILLIMIN E GJYKIMIT TË ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar, se sot, më datë 07.12.2020, ora 13.30, pasi mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen me numër regjistri (JR) 19/2020, datë 09.06.2020, për ankimin e subjektit të rivlerësimit Eneida Civici kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 251, datë 09.03.2020, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 51, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, ditën e **mërkurë, në datën 23.12.2020, ora 13:00**, për t’i dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit Eneida Civici të dëgjohej lidhur me çështjen e saj.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykses, përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuese e Trupit Gjykses	Albana Shtylla
Relator i Çështjes	Sokol Çomo
Gjyqtar	Ardian Hajdari
Gjyqtare	Natasha Mulaj
Gjyqtare	Rezarta Schuetz

Bazuar në nenin 460, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 51, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, kjo shpallje bëhet të paktën 10 ditë para seancës gjyqësore, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe atë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit.

**KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES
GJYQTARE**

ALBANA SHTYLLA

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr. 3, Tiranë, www.kpa.al, e-mail: info@kpa.al

